



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 401-8208/2022

Datë 14.03.2022

Në bazë të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Klinës, miratuar nga Kuvendi me nr.01 Nr.06-8132/2020 të datës 04.03.2020 dhe Vendimit të Asamblesë Komunale nr.01 Nr.06-3504/2022 të datës 02.02.2022, Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURS

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË KLINËS

Sipas konkursit ndahen 40 bursa për studentë të dalluar të Komunës së Klinës në vlerë prej 50 euro për një muaj në kohëzgjatje njëvjeçare për vitin akademik 2021/2022.

I. KUSHTET DHE KRITERET E APLIKIMIT

Për fitimin e bursave të studimeve kanë të drejtë të konkurrojnë kandidatët që i plotësojnë kushtet si në vijim:

- 1.1 Të jenë studentë të cilët studiojnë në universitete publike të Republikës së Kosovës, por jo edhe ata me vetëfinancim, korrespondencë, studentët në studime pasuniversitare- master dhe doktoratë.
- 1.2 Të jenë student të rregullt të viti të 2-të e më lartë.
- 1.3 Të jenë banorë të përhershëm të Komunës së Klinës.
- 1.4 Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa.
- 1.5 Të jenë studentë që nuk janë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër nga buxheti i Kosovës si dhe të mos jenë të punësuar në institucione publike.
- 1.6 Studentë që nuk janë përsëritës të vitit.
- 1.7 Studentë që kanë notën mesatare 7.5 e më të lartë, përveç studentëve të profileve deficitare si në pikën 1.7 të këtij neni.
- 1.8 Përparësi në fitimin e së drejtës për bursë do të kenë studentët që studiojnë në lëmenjtë deficitare (Fakulteti i Mjekësisë- Drejtimi i Përgjithshëm, Stomatologji, Infermieri, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, drejtimet e matematikës-profil i arsimor dhe drejtimet e fizikës-profil i arsimor).

II. KRITERET DHE PËRPARËSITË E PËRFITIMIT TË BURSËS

1. Për suksesin e arritur në studime në vitin paraprak, kandidati vlerësohet me pikë si në vijim:

1.1 Me po aq pikë sa është nota mesatare e studentit.

1.2 Përparësi në start kanë profilet deficitare si nga pika 1.7 të cekur më lart në këtë konkurs dhe do të poentohen me 5 pikë bonus.

III. Nëse përfituesi i bursës ndërron fakultetin, humb të drejtën e shfrytëzimit të bursës.

IV. Studenti përfitues i bursës obligohet ta kthejë bursën e komunës, nëse konstatohet se merr bursë nga ndonjë njësi tjetër buxhetore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim (të gjitha origjinale)

- Certifikata e notave
- Vërtetimi se studenti ka regjistruar semestrin e fundit për vitin akademik 2021/2022 si student i rregullt
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm
- Kopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë i dëshmorit, i viktimave civile të luftës, i veteranit dhe invalidit të luftës apo person me nevoja të veçanta.

Vërejtje:

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e publikimit zyrtar në faqen zyrtare të Komunës së Klinës (nga data 15.03.2022 deri më 30.03.2022).

Pas kësaj date asnjë dokument nuk pranohet. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Të gjithë studentët e interesuar duhet të marrin aplikacionin në DKA dhe të plotësuar bashkë me dokumente të tjera ta dorëzojnë në Drejtorinë e Arsimit në Klinë gjatë orarit zyrtar të punës (8-16).

Për dokumente të pakompletuara dhe jo të vlefshme përgjegjësi do të mbajë studenti që aplikon.

Kundër vendimit të shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga komisioni për ndarjen e bursave lejohet ankesa e cila i drejtohet komisionit të formuar “ad hoc” me vendim të Kuvendit të Komunës. Ankesa ushtrohet në afat prej 7 ditësh nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga ana e komisionit.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesat e ushtruara.

Drejtori i DKA-së

Dr. sc. Qemajl Sejdiu

